



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 6766/Prot
2

Tiranë, më 28.12.2021

UDHËZIM

Nr. 25 datë 28.12.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 "PËR
DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE
MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE,
NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN
OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre" dhe vendimit nr. 112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, i ndryshuar bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit togfjalësh "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë" dhe akronimi "MASR" të zëvendësohen përkatësisht me "Ministria e Arsimit dhe Sportit" dhe "MAS".
 - b) Pika 1 e Kreut I/A.1 ndryshon si vijon:

"1. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, ministria përgjegjëse për arsimin procedon me miratimin e statutit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me miratimin e statutit të institucionit të arsimit të lartë me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, krijimit të organeve kolegjiale dhe emërimit/zgjedhjes së autoriteteve drejtuese, IAL aplikon në platformën e-Albania për hapjen e programeve të studimit sipas procedurave në Kreun IV të këtij udhëzimi. Pas miratimit të statutit

dhe të programeve të studimit, MAS kryen verifikimet në terren për përmbushjen e standardeve dhe të kriterëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”.

b) Pika 6 e Kreut II/A ndryshon si vijon:

“b. Në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit dhe dokumentacionit, ministri miraton me urdhër hapjen e degës si njësi kryesore/bazë e IAL-së dhe dega brenda 30 ditëve nga data e miratimit aplikon në platformën e-Albania për hapjen e programeve të studimit, në funksion të degës si njësi kryesore/bazë të miratuar.”.

c) Germa “e” e pikës 5 të Kreut III/A ndryshon si vijon:

“e. Listën e programeve të studimit dhe planet mësimore që do të mbulohen/mbështeten nga njësia kryesore e re/riorganizuar, listuar sipas njësive bazë përgjegjëse për realizimin e tyre.”.

d) Germa “b” e pikës 6 të Kreut III/A ndryshon si vijon:

“b. Në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit dhe dokumentacionit, ministri miraton me urdhër hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore dhe IAL brenda 30 ditëve aplikon për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit në funksion të njësisë kryesore të miratuar, në platformën e-Albania.”.

e) Nën-pika “v” e germës “e” të pikës 3 të Kreut IV/A shfuqizohet.

f) Në fund të germës “c” të shtojcës nr. 2 të udhëzimit “Plani mësimor/Kurrikula e programit të studimit”, shtohet fjalia si vijon:

“Në rast të aplikimit për riorganizimin e programit të studimit, duhet pasqyra analitike e kurrikulës mësimore ekzistuese, si dhe e kurrikulës mësimore për programin e studimit që aplikohet për riorganizim.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet arsimi të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI
Evis KUSHI

